



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 6.1 të Rregullores (ZKA) Nr. 01/2018 për Marrdhënie Pune si dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Zyra Kombëtare e Auditimit me datën 22 gusht 2019, shpallë:

KONKURS **për plotësimin e vendit të punës**

Pozita: Ndhmës i Auditorit të Përgjithshëm
Referenca: NAP/ZKA/13-08/19
Grada: ZKA/02
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja: Me mandat pesë (5) vjeçar
I përgjigjet: Auditorit të Përgjithshëm
Vendi: Prishtinë

I. Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës dhe i detyrave të punës

Ndhmësi i Auditorit të Përgjithshëm, e ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligj, aktet e brendshme dhe detyrave të caktuara drejtpërdrejt nga Auditori i Përgjithshëm.

Në përputhje me fushëveprimtarinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Ndhmësit të Auditorit të Përgjithshëm i caktohet:

1. Ushtrimi i përgjegjësiave për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të Departamenteve të Auditimit në përputhje me Planin e Vjetor të Auditimit, standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit dhe aktet tjera të Zyrës Kombëtare të Auditimit; dhe/apo

2. Ushtrimi i funksioneve të tjera nga fushëveprimtaria e Zyrës Kombëtare të Auditimit në përputhje me nenin 32 paragrafin 3 të Rregullores (ZKA) Nr.02/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Përcaktimi i përgjegjësiave, përkatësisht funksioneve për Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm të emëruar bëhet me akt të veçantë.

II. Kërkesat themelore për plotësimin e vendit të punës

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike ose administratës publike, prej tyre katër (4) vite përvojë pune menaxheriale;

- I Çertifikuar për auditim të jashtëm në njërin nga skemat e çertifikimit në Kosovë apo jashtë saj (çertifikim për auditor apo auditor i çertifikuar i sektorit publik).

III. Kompetencat/shkathtësitë e kërkua

- Shkathtësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

IV. Procedura e Konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me piken II. të këtij Konkursi.

Vetëm formulari zyrtar i aplikacionit do të merret parasysh. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen, kurse aplikacionet e pakompletuara dhe pa dokumentacion mbështetës do të refuzohen. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen, gjithashtu kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës përkatëse.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në tabelen e shpalljeve, duke filluar nga data 22 gusht 2019.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën <http://www.zka-rks.org/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005.

Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2018 për Marrdhënie të Punës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet:

- Formulari zyrtar i ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore dhe të çertifikimit në auditimin e jashtëm. Diplomat dhe çertifikimet e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara/ njohura sipas legjislacionit në fuqi;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse, duke përfshirë edhe përvojën në Zyrën Kombëtare të Auditimit.